

Gjetjet dhe rekomandimet e konstatuara nga Drejtoria e Auditit te Brendshem nga audidimet e kryera gjate vitit 2016

Ne menyre te permbledhur gjetjet sipas sistemeve jane konstatuar:

Sistemi i menaxhimit të kontrollit të brendshëm n

- hartimin dhe përshtatjen e rregulloreve të brendshme të subjektit, me kushtet aktuale të strukturave;
- aktet dhe procedurat e hartuara për organizimin dhe funksionimin e subjektit;
- zbatimet e VKB për pagat
- emrime të punonjësve në pozicione punë në përputhje me strukturën e miratuar;
- emrime për pozicione punë të punonjësve në përputhje me punën e kryer në fakt;
- nënshkrimin dokumentacionet për pagesat e pagave të punonjësve nga personat e duhur ligjor;

Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.

- kryerjen e shpenzime pa pasur në dispozicion fonde, si rrjedhojë krijuar detyrimeve të papaguara në vlerat te konsiderueshme dhe thellimin e humbjes;
-

Sistemi i prokurimeve:

- ndjekje procedure të ndryshimit të destinacioni të aktivitetit, miratim fondi dhe kryerje procedura prokurimi për investim, duke mos respektuar detyrat, pergjegjesite dhe kompetencat e përcaktuara në aktet ligjore

Sistemi i menaxhimit të aktiveve;

- rregjistrimin e plotë të vlerave të aktiveve në pasqyrat financiare dhe inventar;
- plotësimin e dokumentacionit të plotë të hyrjes se materialeve te riciklueshme të konstatuara gjatë procedurave të vleresimit të materialeve jashtë përdorimit
- Në kryerjen dhe dokumentimin e dorezimeve të pasurivë të paluajtshme të dhëna në përdorim.

Sistemi i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar

- rregjistrimin e plotë të vlerave të aktiveve në pasqyrat financiare dhe inventar;
- rregjistrimin e saktë të veprimeve ekonomike në ditar;
- nënshkrimin, certifikimin dhe dorezimin e pasqyrave financiare

Rekomandimet kryesore të lëna gjatë auditimeve te kryera gjatë vitit 2016 rezultojnë ne keto drejtime:

1. Marrjen e masave për hartimin e rregullores së funksionimit dhe dërgimin për miratim te Kryetari i Bashkisë së Tiranës.
2. Marrjen e masave për hartimin e përshkrimeve të punës me detyrat konkrete për çdo sektor/funksion/punonjës; si dhe hartimin e gjurmëve specifike të auditimit për proceset kryesore të punës që ato mbulojnë.
3. Propozojë pas një studimi të bërë për respektimin e normativave ligjore të ngarkesës së personelit per miratimin e strukturës të detajuar për çdo subjekt, për ato funksionet të paraqitura në grup, të çerdheve.

4. Marrjen e masave për përputhjen e emërimit të punonjësve me emërtimet e “pozicionit” të përcaktuar në strukturës aktuale.
5. Marrjen e masave për shtimin e kontrolleve në të ardhmen me qëllim përmirësimin e procedurave për respektim e afateve të njoftimit të punonjësve në rastit e largimeve nga puna.
6. Marrjen e masave për tu siguruar që nëpunësit që merren me hartimin dhe miratimin e dokumentacionit të pagave të përmirësojnë procedurat e punës krahasuar me gjetjet e konstatuara lidhur me nënshkrimin, përputhjen e numrit rendor me listëprezencat dhe bashkëlidhjen e kopjes së listëpagesave të dërguara në bankë.
7. Marrjen e masave për dokumentacionin e listëpagesave me pagën neto me llogaritë personale të punonjësve për vitet 2011-2014 dhe arshivimin e tyre, ne subjektin ku është konstatuar mangësi.
8. Marrjen në shqyrtim të dokumentacionit ekzistues të diferencave të rezultuara në inventarët dhe rishikimin e mundësive e përdorimit të materialeve si mbeturina apo shitjen e tyre në ankand.
9. Kalimin kapital të vlerës së investimeve të kryera nga Bashkia e Tiranës, në asetet e subjekt/për subjektin e audituar.
10. Marrjen e masa për vendosjen e kontrolleve mbi punën e njësisë së prokurimit lidhur me vendosjen e kritere të arsyeshme në përpjestim me volumin e kontratës dhe natyrën e mallit në DST si dhe me dokumentimin e kthimit në kohë të pagesë “sigurimin e ofertës” operatorve pjesëmarrës.
11. Marrjen e masave për përmirësimet ne sistemin e mbajtjes dhe kontabilizimit e fondeve, akordimet, shtesat dhe pakësimet e fondeve buxhetore gjatë viti si dhe rrakordimet mujor të debitorëve
12. Kërkimin në rrugë ligjore për dorëzimin e dokumentacionit teknik, ekonomik e financiar, kontabël dhe menaxherial, të hartuar nga personel i larguar nga detyra, dhe te padorezuar deri ne momentin e kryerjes se auditimit, ne subjektet ku kane ndodhur transformimet e rendesishme te veprimtarise se subjektit te audituar.
13. Rekomandim per Drejtorine Juridike te BT per paraqitje për ndryshime të VKB-se per organizimin dhe funksionimin e klubit te futbollit.
14. Paraqitjen, certifikimin e pasqyrave financiare te K. Futbollit.
15. Ngritjen dhe përbërjen e një komisioni për marrjen në dorëzim të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara, dhe futjen e tyre në kontabilitetin e Bashkisë së Tiranës nga paksimi kapitalit te klubit sipas VKB.
16. Për gjetjet e konstatuara nga auditimi i sistemeve/fushave të veprimtarisë së ish Njesisë Bashkiake, ku kompetencat për ushtrimin e funksioneve në këto sisteme/fusha me ndryshimet ligjore dhe organizative, nuk ushtrohen nga njësitë administrative,

rekomandohet Titullari i NJA të bashkëpunojë me strukturat e Bashkisë së Tiranës për të marrë masa për ndjekjen dhe zbatimin e tyre.